



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosovo-Republic of Kosovo**  
*Kuvendi - Skupština - Assembly*

---

**Legjislatura IV**

**Sesioni vjeshtor**

Komisioni për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale

Mbledhja nr. 79

Ndërtesa e Kuvendit, salla N-303

Prishtinë, më 25 shtator 2013, në orën 11:00

**PROCESVERBAL**  
**I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR SHËNDETËSI, PUNË**  
**DHE MIRËQENIE SOCIALE**

**Në mbledhje morën pjesë:** Fikrim Damka, Time Kadrijaj, Flora Brovina, Salihe Mustafa, Gëzim Kelmendi, Nazane Breca.

**Munguan:** Liburn Aliu, Bahri Thaçi dhe Sasha Gjokiq.

**Të pranishëm:** Shpresa Haxhijaj, koordinatorë e Komisionit, Xheneta Sopjani, praktikante.

**Mbledhjen e kryesoi,** Fikrim Damka, kryetar i Komisionit

Në këtë mbledhje u propozua ky

Rend dite:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e datës 09.09.2013;
3. Shqyrtimi i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-054 për statusin dhe të drejtat e dëshmorëve, invalidëve, veteranëve, pjesëtarëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, personave të dhunuar gjatë luftës, viktimave civile të luftës dhe familjeve të tyre;
4. Të ndryshme.

*Kryesuesi konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe e hapi mbledhjen me shqyrtimin e pikës së parë të rendit të ditës.*

**1. Miratimi i rendit të ditës**

*Rendi i ditës u miratua pa asnjë ndryshim.*

**2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e datës 09.09.2013**

*Komisioni miratoi pa vërejtje procesverbalin e mbledhjes së mbajtur më 09.09.2013.*

**4. Shqyrtimi i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-054 për statusin dhe të drejtat e dëshmorëve, invalidëve, veteranëve, pjesëtarëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, personave të dhunuar gjatë luftës, viktimave civile të luftës dhe familjeve të tyre**

Fikrim Damka - Tha se grupi punues ka përfunduar punën në amendamentimin e projektligjit, prandaj sot, komisioni do t'i shqyrtojë amendamente e propozuara nga grupi punues.

**Time Kadrijaj** - Tha se gjatë amendamentimit të këtij projektligji, grupi punues ka bashkëpunuar me shoqata të dala nga lufta, kemi marrë parasysh vërejtjet që kanë dalë nga dëgjimi publik, si dhe deputetët e tjerë dhe të gjitha këto i kemi kombinuar.

Amendamentet e propozuara nga grupi punues, janë si vijon:

**Amendamenti 1**

Pas nenit 3 të projektligjit, shtohet nen i ri me këtë përmbajtje:

1. Në nenin 3 të ligjit në fuqi, para paragrafit 1.1, shtohet paragraf i ri si vijon:

**Lufta Çlirimtare e Kosovës** - është lufta e armatosur e popullit të Kosovës e udhëhequr nga UÇK-ja, me qëllim të çlirimit të Kosovës dhe sjelljes së lirisë dhe pavarësisë për popullin e Kosovës, me karakter mbrojtës dhe çlirimtar, e drejtuar ekskluzivisht kundër forcave ushtarake, policore dhe administratës okupuese serbe në Kosovë.

2. Në nenin 3 të ligjit në fuqi, paragrafi 1.1, riformulohet si vijon:

**1.1. Ushtria Çlirimtare e Kosovës** - formacion ushtarak i armatosur dhe i organizuar në baza vullnetare, me uniforma dhe shenja dalluese, me njësi organizative dhe zinxhir komandues, të drejtuar nga Shtabi i Përgjithshëm, nën kontrollin civil të udhëheqjes politike, me mision të qartë për mbrojtjen e popullit të Kosovës nga regjimi pushtues, dëbimin e forcave dhe administratës serbe nga Kosova dhe çlirimin e vendit.

3. Në nenin 3 të Ligjit në fuqi, paragrafi 1.6, riformulohet si vijon:

**1.6. Dëshmor i Kombit** – Luftëtar i UÇK –së që:

1.6.1. ka rënë në luftë për lirinë e vendit;

1.6.2. është plagosur në luftë për lirinë e vendit dhe ka vdekur si pasojë e plagëve të marra brenda tri (3) viteve, pas përfundimit të luftës.

4. Në nenin 3 të Ligjit në fuqi, paragrafi 1.7, riformulohet si vijon:

**1.7. Veteran i UÇK- së** - pjesëmarrës në luftën për çlirimin e Kosovës si:

1.7.1. **Invalid i luftës së UÇK-së** -luftëtari, pjesëtari dhe i internuari (i burgosuri) i UÇK- së, i cili ka pësuar plagë , lëndime (dëmtime ) fizike dhe psikike apo sëmundje të rënda gjatë luftës ose në burgjet dhe kampet e armikut, gjatë periudhës së luftës , me shkallë të invaliditetit së paku 10%.

1.7.2. **Veteran luftëtar i UÇK-së** - është qytetari i Kosovës dhe shtetasi i huaj, i cili është radhitur në radhët e UÇK- së dhe është regjistruar si ushtar i armatosur dhe i uniformuar nga komandat, shtabet e zonave operative të UÇK-së, përkatësisht Shtabi i Përgjithshëm i UÇK së dhe i cili ka qenë aktiv deri në përfundimin e luftës.

1.7.3. **I internuar i UÇK së** - secili person, i cili për shkak të veprimtarisë së tij si pjesëtarë i UÇK- së, është arrestuar gjatë periudhës 1997-1999 dhe është mbajtur në burg nga forcat serbe.

1.7.4. **Pjesëtarë i UÇK së** - çdo person, i cili me vendim apo akt tjetër, është caktuar të kryejë detyra konkrete në mbështetje politike , logjistike , financiare dhe detyra të tjera të marra nga komandantët e njësive, shtabeve dhe zonave të UÇK- së, përkatësisht Shtabi i Përgjithshëm i UÇK- së , gjatë periudhës 1997- 1999.

1.7.5. **Pjesëmarrës i Luftës** - ushtari, i cili është radhitur në radhët e UÇK së, ka qenë i angazhuar në mënyrë aktive për të kontribuar në luftë, por për arsye të ndryshme i ka lëshuar radhët e UÇK- së, para përfundimit të luftës.

1.7.6. **Ushtari i zhdukur( i pagjetur ) i UÇK- së** -veterani ose pjesëtari i UÇK- së , fati i të cilit ende nuk është zbardhur.

5. Në nenin 3 të ligjit në fuqi, fshihen paragrafët: 1.9. 1.11. dhe 1.13.

## **Amendamenti 2**

Neni 6 i projektligjit, riformulohet si vijon:

Neni 6 i ligjit në fuqi, pas paragrafit 9, shtohet një paragraf i ri si vijon:

10. personat e dhunuar gjatë luftës, përfitojnë beneficionet personale, të parapara në paragrafët: 1.5. ; 1.8, si dhe 4 e 6, të nenit 6 të ligjit në fuqi.

### **Amendamenti 3**

Neni 7 i projektligjit, riformulohet si vijon:

Në nenin 14 të ligjit në fuqi, pas paragrafit 2.5, shtohen dy paragrafë të rinj si vijon:

2.6 Përjashtim nga shkalla e invaliditetit bëjnë personat e dhunuar gjatë luftës.

2.7. Baza e pensionit të personave të dhunuar gjatë luftës përcaktohet me vendim të Qeverisë, sipas shtojcës 1 të ligjit në fuqi .

### **Amendamenti 4, Albulena Haxhiu me përkrahjen e Komisionit FunkSIONAL**

Në nenit 7 të projektligjit, pas paragrafit 2.6, të shtohet një paragraf i ri si vijon:

2.7. kompensimi dhe beneficionet tjera që dalin nga ky ligj, përfitohen pas shqyrtimit të rasteve nga komisioni përgjegjës qeveritar.

### **Amendamenti 5**

Pas nenit 7 të projektligjit, shtohet neni i ri si vijon:

Në nenin 15 të ligjit në fuqi, pas paragrafit 9, shtohen tre paragrafë të rinj si vijon:

10. Statusi i personave të dhunuar gjatë luftës, konstatohet nga Komisioni Qeveritar për njohjen dhe verifikimin e statusit të personave të dhunuar gjatë luftës, sipas kushteve dhe kriterëve të përcaktuara me akt nënligjor të nxjerrë nga Qeveria, brenda 6 muajsh, pas hyrjes në fuqi të Ligjit .

11. Komisioni Qeveritar për njohjen dhe verifikimin e statusit të personave të dhunuar gjatë dhunuar gjatë luftës, themelohet me vendim të Qeverisë, brenda 6 muajsh, pas hyrjes në fuqi të ligjit dhe do të përbëhet nga 9 ( nëntë) anëtarë si vijon:

11.1. 1( një ) përfaqësues i Zyrës së Kryeministrit;

11.2. 1( një ) përfaqësues nga Ministria e Punës;

11.3. 1( një ) përfaqësues nga Ministria e Drejtësisë;

11.4. 1( një ) përfaqësues nga Ministria e Shëndetësisë;

11.5. 1( një ) përfaqësues nga Instituti për krime lufte;

11.6. 1( një ) psikolog klinik;

11.7. 1( një ) psikiatër;

11.8. 1( një ) jurist;

11.9. 1( një ) përfaqësues nga shoqëria civile, me përvojë në veprimtarinë e ndihmës dhe mbrojtjes së viktimave të dhunës seksuale.

12. Organizimi i punës, funksionimi, detyrat dhe përgjegjësitë, pagesa për angazhimet e anëtarëve, si dhe çështjet tjera të rëndësishme të Komisionit Qeveritar, do të përcaktohen me akt nënligjor të nxjerrë nga Qeveria e Kosovës.

## **Amendamenti 6**

Neni 8 i projektligjit, riformulohet si vijon:

Në nenin 16 të ligjit në fuqi, pas paragrafit 4, shtohet një paragraf i ri si vijon:

5. Afati përfundimtar për të parashtruar kërkesën, për realizimin e të drejtave në pensione dhe benificione, të përcaktuara sipas këtij ligji për personat e dhunuar gjatë luftës, është (5) vite, nga fillimi dhe zyrtarizimi i punës së Komisionit Qeveritar për njohjen dhe verifikimin e statusit të personave të dhunuar gjatë luftës.

## **Amendamenti 7, Albulena Haxhiu me përkrahjen e Komisionit FunkSIONAL**

Pas nenit 8 të projektligjit, të shtohet një nen i ri si vijon:

Pas nenit 19 të ligjit në fuqi, shtohet nen i ri me këtë përmbajtje:

Mbrojtja e të dhënave për personat të cilët i kanë mbijetuar abuzimit seksual dhe dhunimit.

1. Të dhënat personale, jeta private dhe identiteti i personave si viktimat të dhunës seksuale gjatë luftës, mbrohet nga autoritetet përgjegjëse. Regjistrimi, mirëmbajtja dhe shfrytëzimi i të dhënave personale të këtyre personave, bëhet në pajtim me kushtet e përcaktuara me Ligjin për mbrojtjen e të dhënave personale dhe Kodin Penal.

## **Amendamenti 8**

Nga shtojca e projektligjit, të fshihet fjalia:

**„Pensioni për personat e dhunuar gjatë luftës 300,00 €”.**

**Flora Brovina-** Sa i përket amendamentit të 8-të, të Albulena Haxhiut, kemi propozuar që shumën e pensionit ta caktojë Qeveria.

**Nazane Breca-** Tha se do të ishte mire të caktojmë një shumë minimale dhe maksimale.

**Salihe Mustafa-** Tha se nuk duhet të caktojmë asnjë shumë, sepse ende nuk dihet numri i saktë i këtyre personave.

**Nazane Breca-** Theksoi se duhet që shuma e pensionit të caktohet konform shtojcës së Ligjit nr. 04/L-054 për statusin dhe të drejtat e dëshmorëve, invalidëve, veteranëve, pjesëtarëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, personave të dhunuar gjatë luftës, viktimave civile të luftës dhe familjeve të tyre.

**Fikrim Damka-** Tha se Qeveria do ta caktojë shumën e pensionit për këtë kategori.

*Pas diskutimeve, Komisioni njëzëri miratoi amendamentet e propozuara në Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-054 për statusin dhe të drejtat e dëshmorëve, invalidëve, veteranëve, pjesëtarëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, personave të dhunuar gjatë luftës, viktimave civile të luftës dhe familjeve të tyre, si dhe i procedoi te komisionet kryesore.*

#### **4. Të ndryshme**

*Komisioni formoi grupin punues për shqyrtimin e Projektligjit për Agjencinë e Punësimit të Republikës së Kosovës. Grupi punues përbëhet nga Time Kadrijaj- kryesuese, Nazane Breca, Salihe Mustafa dhe Gëzim Kelmendi- anëtarë.*

**Fikrim Damka-** Tha se kanë ardhur disa kërkesa, një nga Komisioni për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjimore, Persona të Pagjetur dhe Peticione, lidhur me kërkesën e Ilir Jasharit, një nga ish- punëtorët e kompanisë së sigurimit fizik “SFK”- Prizren dhe një ankesë tjetër nga Azem Isaku, që ka të bëjë me refuzimin e kërkesës për pension të personave me aftësi të kufizuara.

**Salihe Mustafa-** Sa i përket Azem Isakut, jam në dijeni që ky person ka të meta fizike, pra nuk është i aftë për punë.

*Pas diskutimit, komisioni konstatoi se çështja e adresuar nuk është në kompetencë të Komisionit për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale.*

#### **E përqatiti:**

**Njësia për Mbështetjen e Komisionit.**

**Kryetari i Komisionit**

---

**Fikrim Damka**